



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 149 Prot.

Tiranë, më 30.01 2018

VENDIM Nr. 23, datë 18.01.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.1, datë 18.01.2018, pasi shqyrtoi Raportin e sondazheve arkeologjike "Faza II", në kuadër të projektit "*Ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve të qytetit të Durrësit*"-subjekti Bashkia Durrës, realizuar nga shoqëri e licencuar, në arkeologji "AD - STAR" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e sondazheve arkeologjike "Faza II", në kuadër të projektit "*Ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve të qytetit të Durrësit*"-subjekti Bashkia Durrës, realizuar nga shoqëri e licencuar, në arkeologji "AD - STAR" sh.p.k.
2. Të vijojnë punimet e ndërtimit për projektin "Projektim dhe Mbikëqyrje e ndërhyrjes në sistemin e kanalizimeve të ujrave të ndotura të Durrësit", duke u kryer ndjekja në mënyrë periodike ditore e punimeve të gërmimit, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet subjektit "Drejtoria e Përgjithëshme e Ujësjellës Kanalizimeve"sh.a., shoqërisë së licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k. dhe ASHA.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUBINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al